REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 319/20
Data/Datum 05.06.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

# RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

| | | |
|---|---|---|
| Blerina Huruglica<br>**Ekspert Shqyrtues** | ***Data e autorizimit të ekspertit***<br>***26.05.2020*** | *Data e dorëzimit të raportit*<br>***05.06.2020*** |

## 1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 21.05.2020, OE "Sfinga Shpk", ka parashtruar ankesë me nr: 319/20, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Krijimi dhe mirmbajtja e brendit pë qytetin e Prizrenit" me nr. të prokurimit: 622-20-923-221, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Prizren.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 80.000,00€.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim:Data e njoftimit për kontratë 17.03.2020, data e hapjes së ofertës 06.04.2020, data e njoftimit për dhënien e kontratës 21.05.2020, data e njoftimit të ofertuesve të pasuksesshëm 07.05.2020)

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

## 2.PRETENDIMET ANKIMORE

Me datë 21.05.2020, OE "Sfinga Shpk", si palë e pakënaqur ka parashtruar ankesë me nr: **319/20**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "GOE Office 1 Kosova& Idea Plus", lidhur me aktivitetin e prokurimit numër **"622-20-923-2-2-1"**, respektivisht atij me titull "**Krijimi dhe mirmbajtja e brendit për qytetin e Prizrenit**", iniciuar nga AK – **KK Prizren**.

**OE ankues ka pretenduar që është shkelur kjo dispozita ligjore:Neni 69, paragrafi 1 i LPP-së.**

OE ankues në momentin e njoftimit si tenderues i pasuksesshëm në E-prokurim me datë 07.05.2020, në të njejtën ditë i është drejtuar Ak-së për casje në dokumente të procedurës, dhe kjo e fundit ka caktuar datën 08.05.2020.
Pas pjesemarrjes në casje të dokumenteve gjetëm mangësi në procedurën ndaj GOE Office1Kosova&Idea Plus Communication.
OE e rekomanduar fillimisht gjatë ofertimit – dorëzimit të dokumenteve në platformën elektronike e-prokurim, nuk ka dorëzuar dokumente në pajtim me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, konkretisht pikën 9.1 & 9.2 pika 2 e FDT-së, pastaj me date 22.04.2020 AK i është drejtuar OE-se rekomanduar me letër standarde për sqarim të tenderit, dhe po e njejta i eshte pergjigjur me email me datë 23.04.2020.
OE ankues pretendon se:

1 Dokumentet e dorezuara nga GOE OFFICE 1 KOSOVA & IDEA PLUS COMUNICATION në E-prokurim të kërkuara nga AK - Prizren i drejtohet po të njejtit me Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit, dhe i njejti dorezon në attach dokumentin e compresuar Dokumente per sqarim në lidhje me stafin profesional si dhe OE ankues gjenë mangësi në këto dokumente ku Kontrata mbi vepër me Enver Sulaj - nuk është e nënshkruar nga Lideri i GOEOFFICE1KOSOVA por vetëm e vulosur.

2 Kërkesa e AK-s në DT për " Një ekspert i lëmisë së turizmit i diplomuar në fakultetin e turizmit dhe një përvojë pune së paku 3 vite në profesion. " GOE OFFICE 1 KOSOVA & IDEA PLUS COMUNICATION ka Dorezuar z. Blazhevski Aleksandar si Ekspert i diplomuar në Fakultetin e Turizmit . GOE – nuk ka kontratë as marrëveshje bashkëpunimi as kontratë mbi vepër me z. Blazhevski Aleksandar . Poashtu nuk ka diplome adekuate pasi qe kerkesa eshte te jetë i Diplomuar Në Turizëm , kurse z.Blazheski ka diplomë për Studime 3 Vjecare qe do te thote është BACHELOR , ( jo 4 vjecar i diplomuar)

3 Partneri i GOE – IdeaPlus Communication ka dorezuar një dokument crm.pdf nga Regjistri Qendror I Maqedonis se Veriut – Raport i Bilancit të gjendjes dhe te dhënat për bilancin e Suksesit - i Perkthyer nga z.Ilir Ivanovzki – dhe nuk është askund origjinali në gjuhën Maqedone. Partneri poashtu nuk ka dorezu asnjë Certfifikatë Biznesi , Fiskale apo ndonje listë të pagave.

4 Mungesa e Referencave dhe kontratave adekuate per GOE Office1Kosova dhe IdeaPlus Communication . Lideri Office1Kosova nuk ka dorezu asnjë Kontrate as referencë që lidhet me kontratën e shperblyer. Partneri IdeaPlusCommunication nuk ka dorëzu asnjë kontratë e referenc valide bindese qe lidhet me kontraten e shperblyer . Ka dorezu një Kontratë me kompanin EVN Kompani aksionare e furnizimit me energji elektrike e që lënda e kësaj ka të bejë me Planifikim Medial dhe Qiranë blerje e hapesirave reklamuese mediave . Edhe vlera e kësaj kontrate specifikohet që nuk mund të kaloj vleren 200.000,00 ( dyqindmije euro) dhe valide nga 01.05.2019 deri me 01.05.2020 . Edhe tek referenca e prezentuar nuk shkruan asnje vlerë monetare e realizimit te projekteve apo duke specifikuar kontratën në fjalë me numër apo datë. Eshte referenca me date 30.01.2020 e pergjithshme ku citohet bashkëpunimi me Idea Plus Komunikime për fushatat reklamuese. Poashtu Referenca nuk është e vulosur. Nuk ka asnjë dëshmi qe vërteton vleren e realizimit te kontratës, nuk ka ndonje transfer bankar për të dëshmuar

transaksionin e kësaj kontrate mes palëve, apo ndonjë procesverbal që dëshmon vlerën e punëve të realizuara.

5 Mungon Kontrata me Menaxherin e Projektit – z.Besim Mikullovci As në dorëzimin e ofertave në e-prokurim as në dorëzimin e dokumenteve sqarime shtese nuk gjindet Kontrata me Menaxherin e Projektit e GOE Office1Kosova & IdeaPlusCommunication . As AK-Prizren nuk e ka kerku këtë dokument ne Kerkesen per sqarim te dosjes . Ky dokument është futur ne dosje me datë 06.05.2020 ose pas kësaj date - jashte afatit per sqarime . Pasi qe nuk ka asnjë dëshmi qe eshte ngarkuar , apo kërkuar si dokument shtese . Mungon Dëshmia e Menaxherit te Projektit – z.Besim Mikullovci të ketë menaxhuar së paku një projekt të natyrës së Kontratës ( Brendim,Fotografi Origjinale , tekste origjinale , spote , harta ) nuk kan dorëzu ndonje kontratë që i pergjigjet kerkesës me Dt. apo edhe referencen per perfundim te kontrates se menaxhuar nga Menaxheri i emeruar i projektit.

6 Mungojne dokumentet e GOE OFFICE 1 KOSOVA & IDEA PLUS COMUNICATION - Vërtetimin e ATK-së / - Vërtetimi i Tatimit në Pronë dhe - Vërtetimi i Gjykates Ekonomike Në dosje është e Specifikuar kërkesa : b).Vërtetim nga Administrata Tatimore (kopje). c).Vërtetim nga Gjykata Themelore Departamenti për Qështje Ekonomike (kërkohet origjinal ose i vërtetuar noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit). D. Vërtetimi i tatimit në pronë Ku edhe në dosje është e cekur Dokumentet (nën b, c dhe d) duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues,para publikimit të dhënies së kontratës.Në rast të dështimit në dorzimë të dokumentave të tilla,tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar Lideri ka Dorezuar një deklaratë nën betim te datës 06.05.2020 ku shkruan "Për shkak të Covid-19 jemi në pamundësi që sigurohen vërtetimet e kërkuara në dt. dhe të njëjtat do ti Sjellim me krijimin e kushteve " Me këtë deklaratë AK bën shkelje dhe vazhdon me procedurat e njoftimmit te Vendimit dhe shperblen me kontrate këtë OE . Këto dokumente nuk ka qenë e pamundur te sigurohen , kur dihet se Vertetimi i Atk-se mund te mirret ne forme elektronike , Vertetimet Tatimi ne Prone dhe Gjykata Ekonomike edhe keto mund te sigurohen pasi te gjitha bizneset kishin te drejte levizje me dokument te shkarkuar ne forme elektronike nga webfaqja e ATK-se . Edhe kjo deklarate nen Betim ka po te njejten date sikurse " Kontrata e futur pas afatit me Menaxherin e Projektit " May 6 2020 . – 1 dite para Shperblimit me Kontratë te GOE Office1Kosova & IdeaPlusCommunication

7 Çmime jo-normalisht të ulëta në paramasë të Ofruara nga GOE Office1Kosova & IdeaPlusCommunication 90 % të buxhetit është paraparë vetëm për foto dhe punë që lidhen me foto ( vetëm në 4 pozicione ) Ndërsa për të gjitha pozicionet tjera është ofert nga 149 euro për pozicion / njësi . -A krijohet Identiteti vizual i rajonit te Prizrenit me 149 euro ? -A Krijohet Brendbook per 149 euro ? -A mund të krijohet nje video promocionale me kohëzgjatje 5 minutëshe për 149 euro ? -A mund te krijohet harta interaktive për 149 euro ? -A mund të krijohet dhe menaxhohet web faqja për brendin e ri te Prizrenit për 1 vit për 149 euro ? -A mund të menaxhohen Rrjetet Sociale për 1 vit me nga 2 postime në jave Instagram dhe facebook për - 149 euro për komplet periudhën 1 vjecare ? me kosto mujore 12,41 euro, javore 3.10 euro e për artikull 1.55 euro ??? -Po dizajnimi i Souvenir shop-it me 149 euro ? -Edhe Mobilimi i Souvenir shop-it me 149 ? -A mund te menaxhohet Souvenir shop për 2 vjet rresht me kosto 2 vjecare 149 euro ? kosto mujore 6.21 euro ? -Mesiguri edhe mirembatja e brendit 2 vjecar mund të bëhet për vetëm 149 euro?

8 Lideri i Goe ne Certifikaten e Regjistrimit të Biznesit nuk ka asnjë shifer të aktivitet që përkon me DT – Paramasën.

I njejti mendon se OE e rekomanduar nuk i plotëson kriteret teknike dhe profesionale.

## 3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

| | |
|---|---|
| **III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:**<br><br>**Kërkesat a).Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr.04 L-042.për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 .Neni 65. b)Në dokument nga Administra Tatimore e vendit tuaj të themelimit,se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës. c)Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush Kërkesat e përshtatshmeris të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit para datës se publikimit të Njoftimit të Kontratës d një dëshmi se ju keni përmbushë obligimet e tatimit në pronë së paku deri në muajin paraprak nga data e hapjes së ofertave** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:*<br><br>**a. Deklarata nën betim e cila është pjesë e DT të plotësohet nënshkruhet dhe vuloset në original b).Vërtetim nga Administrata Tatimore (kopje). c).Vërtetim nga Gjykata Themelore Departamenti për Qështje Ekonomike (kërkohet origjinal ose i vërtetuar noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit). D. Vërtetimi i tatimit në pronë Dokumentet (nën b, c dhe d) duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues,para publikimit të dhënies së kontratës.Në rast të dështimit në dorzimë të dokumentave të tilla,tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar** |
| **III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:**<br><br>**Kërkesa 1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional,komercial dhe apo Regjistrin e ndermarjeve në vendin e juaj të themelimit Kërkesa 2.Regjistrimi i Numrit Fiskal Kërkesa 3 OE duhet të jetë i regjistruar në TVSH ose të jetë deklarues i TVSH së** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:*<br><br>**Evidenca 1 Certifikata e regjistrimit të biznesit me informatat për biznesin (kopje). Evidenca 2 Certifikata e numrit fiskal Evidenca 3 Qertefikata e TVSH së** |
| **III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**<br><br>**3. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjat tri viteve të shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) ka qen prej jo më pak se 160.000,00 €** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:*<br><br>**Evidenca 1 Pasqyrat e qarkullimit financiare të kompanisë, të shoqëruar me qarkullimi financiar nga banka për tri vitet e shkuara apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.** |
| **III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:**<br><br>**Kërkes 1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera,minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 50.000,00 € OE duhet të dëshmojë se ka përfunduar me sukse së paku një projekt të natyrës së kontratës në tri vitet e shkuara Kërkesa 2 a. Në kuadër të stafit duhet të** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:*<br><br>**Dëshmia 1 Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skenuar nga origjinali) për dosien elektronike, , të deshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e shërbimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të shërbimeve. Dëshmija 2 Në pikën a. diploma e menaxherit, dëshmi mbi përvojën në punë, dëshmi mbi menaxhimin e projekteve, kontrata e punës ose e bashkëpunimit me OE në fjalë. a. b. c. d. e** |

| | |
|---|---|
| caktohet menaxheri I projektit I cili duhet të jetë ingjinjer I diplomuar I shkencave të artit drejtimi i dizajnitt ose master me jo më pak se 5 vite përvojë pune në profesion - Të ketë menaxhuar së paku një projekte të natyrës së kontratës. b. Një profesor të Historisë i cili duhet të ketë fakultetin e historisë dhe së paku 5 vite përvojë pune në profesion c. Një profesor të gjuhës dhe letërsisë shqipe i cili ka dëshmi se ka ushtruar punën e lektorit në ndonjë institucion të caktuar, të ketë fakultetin dhe së paku 5 vite përvojë pune në profesion nga të cilat tri vite në lektorim d. Një ekspert i lëmisë së turizmit i diplomuar në fakultetin e turizmit dhe një përvojë pune së paku 3 vite në profesion. e. Një fotografist profesional i diplomuar në fakultetin e arteve dega për fotografi. | Dëshmi mbi kualifikimin e stafit professional të kërkuar, dëshmi mbi përvojën, kontrata e punës ose e bashkëpunimit për këtë project. |

## 4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Tenderi i OE Ankuesit [nuk qe më i favorshmi nga aspekti ekonomik] [ nuk qe tenderi me çmimin më të ulët]

## 5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

*N/A*

## 6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

*N/A*

## 7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

**Pas shqyrtimit në detaje të lëndës së tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe duke u bazuar në dokumentacionin në dispozicion, eksperti shqyrtues jep këtë mendim si në vijim:**

**Pretendimi nr.1** Dokumentet e dorezuara nga GOE OFFICE 1 KOSOVA & IDEA PLUS COMUNICATION në E-prokurim të kërkuara nga AK - Prizren i drejtohet po të njejtit me Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit, dhe i njejti dorezon në attach dokumentin e compresuar Dokumente per sqarim në lidhje me stafin profesional si dhe OE ankues gjenë mangësi në këto dokumente ku Kontrata mbi vepër me Enver Sulaj - nuk është e nënshkruar nga Lideri i GOEOFFICE1KOSOVA por vetëm e vulosur.

**Eksperti Shqyrtues pas vlerësimit të dokumenteve të tenderit dhe shkresave të dërguara, gjen se kontrata e Enver Sulaj është e vulosur nga punëdhënësi mirpo nuk është e nëshkruar, ky pretendim mund të merret si pjesërisht i bazuar, dhe konform nenit 72 të LPP-së, AK-ja mund të kërkoj sqarime shtesë.**

**Pretendimi nr.2** Kërkesa e AK-s në DT për " Një ekspert i lëmisë së turizmit i diplomuar në fakultetin e turizmit dhe një përvojë pune së paku 3 vite në profesion. " GOE OFFICE 1 KOSOVA & IDEA PLUS COMUNICATION ka Dorezuar z. Blazhevski Aleksandar si Ekspert i diplomuar në Fakultetin e Turizmit . GOE – nuk ka kontratë as marrëveshje bashkëpunimi as kontratë mbi vepër me z. Blazhevski Aleksandar . Poashtu nuk ka diplome adekuate pasi qe kerkesa eshte te jetë i Diplomuar Në Turizëm , kurse z.Blazheski ka diplomë për Studime 3 Vjecare qe do te thote është BACHELOR , ( jo 4 vjecar i diplomuar)

Eksperti Shqyrtues pas vlersimit thekson se, Ak-ja në momentin që ka vërejtur që mungojnë dokumentet e kërkuar si ne DT, ka kërkuar nga OE e rekomanduar për sjelljen e ktyre dokumenteve, mirpo e njejta nuk ka dorzuar të gjitha siq edhe janë kërkuar , por që Ak-ja i ka marr si të mirëqene këto dokumente, dhe i ka kthyer përgjigje OE ankuesit:

Lidhur me ekspertin e turizmit, në DT është Diploma dhe CV ndërsa I njëjti është edhe pronar I OE IDEA PLUS COMUNICATION andaj I njëjti nuk ka nevoj të ptrezantoj kontrataën e punës me kompanin e tij.

**Eksperti Shqyrtues pas vlerësimit të dokumenteve të tenderit dhe shkresave të dërguara, gjen pretendimin si pjesërisht të bazuar. Tek oferta e OE së rekomanduar, ka vërejtur që ka mangësi tek këto dokumente, dhe shihet qartë se z. Blazhevski Aleksandar ka diplomë në Turizëm, mirpo mungon kontrata mbi bashkpunimin ose dëshmia që është pronar ne këtë kompani, ashtu siq deklaron AK-ja.**

**Pretendimi nr.3** Partneri i GOE – IdeaPlus Communication ka dorezuar nje dokument crm.pdf nga Regjistri Qendror I Maqedonis se Veriut – Raport i Bilancit të gjendjes dhe te dhenat per bilancit e Suksesit - i Perkthyer nga z.Ilir Ivanovzki – dhe nuk eshte askund origjinali ne gjuhen Maqedone. Partneri poashtu nuk ka dorezu asnje Certfifikate Biznesi , Fiskale apo ndonje liste te pagave.

**Eksperti Shqyrtues pas verifikimt ka vërejtur se Partneri GOE- IdeaPlus Communication ka dorzuar vetem nji raport të bilancit të gjendjes dhe të suksesit te pëkthyer në gjuhën shqipe, dhe të njejtat nuk figurojnë në DT në gjuhën maqedone, gjithashtu mungojnë dokumentat e Biznesit si: Certifikata Biznesit, Fiskale dhe Vertetimi) dhe e gjenë pretendimin si të bazuar.**

**Pretendimi nr.4** Mungesa e Referencave dhe kontratave adekuate per GOE Office1Kosova dhe IdeaPlus Communication . Lideri Office1Kosova nuk ka dorezu asnjë Kontrate as reference qe lidhet me kontratën e shperblyer. Partneri IdeaPlusCommunication nuk ka dorëzu asnje kontrate e referenca valide bindese qe lidhet me kontraten e shperblyer . Ka dorezu nje Kontrate me kompanin EVN Kompani aksionare e furnizimit me energji elektrike e që lënda e kesaj ka të bejë me Planifikim Medial dhe Qiranë blerje e hapesirave reklamuese mediave . Edhe vlera e kesaj kontrate specifikohet që nuk mund të kaloj vleren 200.000,00 ( dyqindmije euro) dhe valide nga 01.05.2019 deri me 01.05.2020 . Edhe tek referenca e prezentuar nuk shkruan asnje vlerë monetare e realizimit te projekteve apo duke specifikuar kontraten në fjalë me numër apo datë. Eshte referenca me date 30.01.2020 e pergjithshme ku citohet bashkëpunimi me Idea Plus Komunikime për fushatat reklamuese. Poashtu Referenca nuk është e vulosur. Nuk ka asnjë dëshmi qe vërteton vleren e realizimit te kontratës, nuk ka ndonje transfer bankar për të dëshmuar transaksionin e kësaj kontrate mes palëve, apo ndonjë procesverbal qe dëshmon vlerën e punëve

te realizuara.

**Eksperi Shqyrtues vlerëson se OE i rekomanduari për kontratë në DT ka ofruar një kontratë te lidhur në mes të EVN Macedonia dhe antarit të konsorciumit në vlerë prej 200 mij euro, ndërsa në referencë nuk shkruan vlera, andaj ky pretendim i OE ankuesit merret si pjesërisht i bazuar.**

**Pretendimi nr.5** Mungon Kontrata me Menaxherin e Projektit – z.Besim Mikullovci As në dorëzimin e ofertave në e-prokurim as në dorëzimin e dokumenteve sqarime shtese nuk gjindet Kontrata me Menaxherin e Projektit e GOE Office1Kosova & IdeaPlusCommunication . As AK-Prizren nuk e ka kerku këtë dokument ne Kerkesen per sqarim te dosjes . Ky dokument është futur ne dosje me datë 06.05.2020 ose pas kësaj date - jashte afatit per sqarime . Pasi qe nuk ka asnjë dëshmi qe eshte ngarkuar , apo kërkuar si dokument shtese . Mungon Dëshmia e Menaxherit te Projektit – z.Besim Mikullovci të ketë menaxhuar së paku një projekt të natyrës së Kontratës(Brendim,Fotografi Origjinale , tekste origjinale , spote , harta ) nuk kan dorëzu ndonje kontratë që i pergjigjet kerkesës me Dt. apo edhe referencen per perfundim te kontrates se menaxhuar nga Menaxheri i emeruar i projektit.

**Eksperti Shqyrtues këtë pretendim e vlerëson të bazuar pjesërisht për arsye se Ak-ja në e-mailin e dërguar më 22.04.2020 ka kërkuar sqarime edhe për Menaxherin e Projektit duke kërkuar nji kontratë pune ose kontratë bashkëpunimi për këtë projekt, dhe i njejti OE i rekomanduar ia ka bashkangjitur dëshmitë siq janë: Diplomat e noterizuara, nji CV dhe një marveshje si Menaxheri i kontratës Besim Mikollovci, gjersa ne III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE 4) Kapaciteti teknik dhe profesional:**
**Kërkesa 2 a. Në kuadër të stafit duhet të caktohet menaxheri I projektit I cili duhet të jetë ingjinjer I diplomuar I shkencave të artit drejtimi i dizajnit ose master me jo më pak se 5 vite përvojë pune në profesion - Të ketë menaxhuar së paku një projekte të natyrës së kontratës, si dhe Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmija 2 Në pikën a. diploma e menaxherit, dëshmi mbi përvojën në punë, dëshmi mbi menaxhimin e projekteve, kontrata e punës ose e bashkëpunimit me OE në fjalë.**

**Gjerësa mungon dëshmi mbi përvojën në punë, dëshmi mbi menaxhimin e projekteve, kontrata e punës ose e bashkëpunimit me OE në fjalë.**

**Pretendimi nr.6** Mungojne dokumentet e GOE OFFICE 1 KOSOVA & IDEA PLUS COMUNICATION - Vërtetimin e ATK-së / - Vërtetimi i Tatimit në Pronë dhe - Vërtetimi i Gjykates Ekonomike Në dosje është e Specifikuar kërkesa : b).Vërtetim nga Administrata Tatimore (kopje). c).Vërtetim nga Gjykata Themelore Departamenti për Qështje Ekonomike (kërkohet origjinal ose i vërtetuar noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit). D. Vërtetimi i tatimit në pronë Ku edhe në dosje është e cekur Dokumentet (nën b, c dhe d) duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues,para publikimit të dhënies së kontratës.Në rast të dështimit në dorzimë të dokumentave të tilla,tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar Lideri ka Dorezuar një deklaratë nën betim te datës 06.05.2020 ku shkruan "Për shkak të Covid-19 jemi në pamundësi që sigurohen vërtetimet e kërkuara në dt. dhe të njëjtat do ti Sjellim me krijimin e kushteve " Me këtë deklaratë AK bën shkelje dhe

vazhdon me procedurat e njoftimmit te Vendimit dhe shperblen me kontrate këtë OE . Këto dokumente nuk ka qenë e pamundur te sigurohen , kur dihet se Vertetimi i Atk-se mund te mirret ne forme elektronike , Vertetimet Tatimi ne Prone dhe Gjykata Ekonomike edhe keto mund te sigurohen pasi te gjitha bizneset kishin te drejte levizje me dokument te shkarkuar ne forme elektronike nga webfaqja e ATK-se . Edhe kjo deklarate nen Betim ka po te njejten date sikurse " Kontrata e futur pas afatit me Menaxherin e Projektit " May 6 2020 . – 1 dite para Shperblimit me Kontratë te GOE Office1Kosova & IdeaPlusCommunication

**Eksperti Shqyrtues pas vlerësimit të dokumenteve të tenderit, gjen pretendimin si të pa bazuar. Për arsye se këto kërkesa nuk janë kërkesa kualifikuese, si dhe në këtë kohë të pandemisë KRPP-ja ka nxjerr një njoftim:**

*Njoftim Për të gjitha Autoritet Kontraktuese (AK) dhe Operatorët Ekonomik (OE), për të bërë më të lehtë procesin e tenderimit dhe lehtësimin e procedurave tenderuese, publikuar me datë 21.04.2020*

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
Regulatorna Komisija Javne Nabavke
Public Procurement Regulatory Commission

Nr. 41/2020
Datë: 21.04.2020

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në Vendimin e Ministrisë së Shëndetësisë të dt.14.04.2020 **për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19 në territorin e komunës**(ve) në karantinë, me qëllim të mbrojtjes së shëndetit publik, për të bërë më të lehtë procesin e tenderimit në këtë situatë pandemie, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik nxjerrë këtë:

**NJOFTIM**

**Për të gjitha Autoritetet Kontraktuese (AK) dhe Operatorët Ekonomik (OE)** lidhur me kriteret e përzgjedhjes, për derisa jemi në një situatë pandemie dhe derisa janë në fuqi vendimet e Ministrisë së Shëndetësisë për masat mbrojtëse kundër COVID-19, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik **OBLIGON** autoritetet kontraktuese të cilët shpallin tender në një situatë të tillë, të mos kërkojnë dokumente **të noterizuara** , si dhe të mos kërkojnë **katalogje** në dokumentet e tenderimit pasi që është e pamundur të sigurohen këto dëshmi

Në rast se Autoritet Kontraktuese i kanë specifikuar tashmë kërkesat e lartcekura në dokumentet e tenderimit, t'i korrigjojnë ato dhe të zgjasin afatin e tenderimit në përputhje me nenin 53 të LPP-së.

Osman VISHAJ

Kryetar i Komisionit Rregullativ te Prokurimit Publik

**Pretendimi nr.7** Çmime jo-normalisht të ulëta në paramasë të Ofruara nga GOE Office1Kosova & IdeaPlusCommunication 90 % të buxhetit është paraparë vetëm për foto dhe punë që lidhen me foto ( vetëm në 4 pozicione ) Ndërsa për të gjitha pozicionet tjera është ofert nga 149 euro për pozicion / njësi . -A krijohet Identiteti vizual i rajonit te Prizrenit me 149 euro ? -A Krijohet Brendbook per 149 euro ? -A mund të krijohet nje video promocionale me kohëzgjatje 5 minutëshe për 149 euro ? -A mund te krijohet harta interaktive për 149 euro ? -A mund të krijohet dhe menaxhohet web faqja për brendin e ri te Prizrenit për 1 vit për 149 euro ? -A mund të

menaxhohen Rrjetet Sociale për 1 vit me nga 2 postime në jave Instagram dhe facebook për - 149 euro për komplet periudhën 1 vjecare ? me kosto mujore 12,41 euro, javore 3.10 euro e për artikull 1.55 euro ??? -Po dizajnimi i Souvenir shop-it me 149 euro ? -Edhe Mobilimi i Souvenir shop-it me 149 ? -A mund te menaxhohet Souvenir shop për 2 vjet rresht me kosto 2 vjecare 149 euro ? kosto mujore 6.21 euro ? -Mesiguri edhe mirembatja e brendit 2 vjecar mund të bëhet për vetëm 149 euro?

**Sa i përket pretendimit shtatë, Eksperti Shqyrtues mendon se konform nenit 61 të LPP-së, kjo është përgjegjësi e Ak-së , mirpo gjatë rivlerësimit AK-ja mund të kërkoj sqarime shtesë.**

**Pretendimi nr.8** Lideri i Goe ne Certifikaten e Regjistrimit të Biznesit nuk ka asnjë shifer të aktivitet që përkon me DT – Paramasën.

Ak-ja në këtë pretendim i është përgjigjur që:

Në mesin e shum shifrave të Office 1 Kosova janë edhe shifrat e veprimtarisë 1813 si dhe 6209 të cilat kanë të bëjnë me natyrën e Kontratës.

**Eksperti Shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë Office 1 Kosova, si aktivitete tjera në Certifikatën e Biznesit i ka edhe kodet 1813 dhe 6209 të cilat kanë të bëjnë me natyrën e kontratës, ashtu siq potencohet edhe nga Ak-ja.**

## 8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

**Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërishtë e bazuar, dhe ky aktivitet i prokurimit të kthehet ne rivlerësim.**

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KK Prizren.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues –Sfinga SHPK